



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 433/6 prot.

Tiranë, më 24.04.2026

REKOMANDIM

Nr. 24, datë 24.04.2026

PËR KONTROLLUESIN
“DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹ (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve” (në vijim, “Kontrolluesi ose DPB”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 35, datë 09.02.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. DPB është person juridik publik, që ushtron veprimtarinë e saj në varësi të ministrit të Drejtësisë. DPB organizohet në nivel qendror dhe në nivel vendor nëpërmjet

¹Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim, “IEVP”) dhe Qendrës Spitalore të Burgjeve (në vijim, “QSB”).

Bazuar në vendimin nr. 127, datë 03.03.2021 të Këshillit të Ministrave, DPB ka në objekt të veprimtarisë, të garantojë organizimin dhe funksionimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe trajtimin e të burgosurve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet më të mira ndërkombëtare, me qëllim garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar, si dhe rehabilitimin social e riintegrimin e tyre në shoqëri.

Grupi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e një hetimi administrativ gjithëpërfshirës pranë DPB në nivel qendror dhe vendor, ka identifikuar detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të përfshira në këtë proces, si dhe ka marrë në konsideratë llojin dhe numrin e lartë të të dhënave personale që përpunohen gjatë veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse të sistemit penitenciar në Republikën e Shqipërisë.

Për realizimin e një procesi administrativ të plotë dhe të saktë, Zyra e Komisionerit, mbështetur në pikën 1/h, të nenit 82, pikën 1/ç, të nenit 83 të Ligjit, si dhe në objektin e hetimit administrativ të Urdhrit 35, datë 09.02.2026 të Komisionerit, e ka shtrirë hetimin administrativ në disa prej strukturave të varësisë së DPB, si QSB, IEVP Pojskë dhe Instituti i të Miturve Kavajë.

2. Kontrolluesi, bazuar në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ligjin nr. 80/2020 “Për policinë e burgjeve”, ligjin nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, legjitimohet të përpunojë të dhëna personale për kategoritë: “punonjës”, “të dënuar”, “të paraburgosur”, “vizitorë” dhe “staf akademik”.

Gjithashtu, konstatohet se, DPB dhe institucionet e varësisë së saj, në funksion të veprimtarisë së tyre, përpunojnë të dhëna personale, sipas kategorive: “Emër”, “Atësia”, “Mbiemër”, “Data e lindjes”, “Nr. i identifikimit”, “Gjinia”, “Vendlindja”, “Shtetësia”, “Adresa”, si dhe të dhëna sensitive, të tilla si: “Kartela shëndetësore”, “Përgjegjshmëria psikike”, “Analiza gjaku”, “Gjendja penale”, “Të dhëna biometrike” “Sekrecione biologjike” etj.

Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike, sipas strukturave përkatëse.

3. Nga komunikimet dhe verifikimet e realizuara në terren, nga grupi i hetimit administrativ me përfaqësuesit e DPB si dhe me përfaqësuesit e secilës drejtori, rezulton se:
 - Drejtorja e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Gjendjes Gjyqësore, në kuadër të pranimit, regjistrimit dhe akomodimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, përpunon

të dhëna personale identifikuese (gjeneralitete, dokumente identifikimi, fotografi), të dhëna procedurale dhe penale (vendime gjyqësore, urdhra ekzekutimi, procesverbale arrestimi dhe kontrolli personal, të dhëna mbi paraburgimin ose dënimi penal), të dhëna që administrohen në institucion (dosja personale, regjistra, procesverbale), si dhe të dhëna familjare dhe kontakte për qëllime komunikimi. Gjithashtu, përpunohen të dhëna personale sensitive, si të dhëna shëndetësore (kartela mjekësore, kontrolli në momentin e pranimit, gjendja fizike dhe mendore) dhe të dhëna biometrike (fotografi dhe gjurmë gishtërinjsh).

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve përpunon të dhëna personale të punonjësve të sistemit të burgjeve si dhe të dhëna për aplikantët që konkurojnë për t'u punësuar në sistemin e burgjeve. Këto të dhëna personale administrohen në dosje fizike dhe në formatin "excel".

Konstatohet se, në dosjet e personelit të larguar dhe të aplikantëve për punë ruhen kopje të jetëshkrimit, mjete i identifikimit, diploma, certifikata, listë notash, vërtetim i gjendjes gjyqësore, raport mjeko-ligjor, si dhe formularë vetëdeklarimi. Nga analizimi i këtyre dokumenteve rezulton se, Kontrolluesi nuk ka përcaktuar afate konkrete për ruajtjen e të dhënave personale që administrohen në funksion të veprimtarisë së tij. Për pasojë, të dhënat personale të përfshira në këto dosje nuk trajtohen në përputhje me kufizimin në kohë të ruajtjes, duke mos garantuar që ato të mbahen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe përpunuar.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa konkrete për përcaktimin e afateve konkrete për ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin, të parashikuar në pikën 2, të nenit 6 të Ligjit, që nënkupton se të dhënat personale mbledhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, si dhe në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave.

- Drejtoria e Çështjeve Sociale përpunon të dhëna personale të tilla si: *"të dhëna arsimore"*, *"punësimi"*, *"gjendja shëndetësore"*, *"situata social-ekonomike"*, *"masat disiplinore"*, *"niveli i riskut"* dhe *"vlerësimi i sjelljes"*.

- Drejtoria e Policisë së Burgjeve realizon ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në IEVP, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të të burgosurve në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
 - Sektori i komunikimit dhe monitorimit elektronik, i cili është pjesë e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve, organizon punën për mbajtjen në gatishmëri të pajisjeve dhe sistemeve elektronike, si dhe siguron mirëmbajtjen e sistemeve që shërbejnë për rritjen e sigurisë.
4. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, e miratuar më datë 01.03.2019, por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se, kjo e fundit i referohet modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit dhe në të mungojnë rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale, konfidencialitetin, aksesin në të dhënat personale, afatet e mbajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave të përpunuara manualisht dhe elektronikisht, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.

Nga analizimi i kësaj rregulloreje, konstatohet se në nenin 21 të saj “*Monitorimi dhe regjistrimi i aksesit në të dhëna personale*”, përcaktohet në mënyrë të përgjithshme se periudha e ruajtjes së të dhënave është e njëjtë me atë të ruajtjes së dokumentacionit shkresor apo elektronik, në përmbajtje të të cilit ndodhen këto të dhëna personale. Gjithashtu, referuar parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe deklarimeve të përfaqësuesve të Kontrolluesit, dokumentacioni asgjësohet pas kalimit të afateve të ruajtjes së të dhënave.

Për më tepër, nga shqyrtimi i rregullores së miratuar “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, si dhe nga analizimi i akteve të tjera rregullatore dhe dokumentacionit shtesë të vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, konstatohet se në asnjë dispozitë të tyre nuk janë përcaktuar afate të qarta dhe konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit dhe institucioneve të varësisë nuk është vendosur në dispozicion asnjë akt apo formë që dëshmon asgjësimin e të dhënave personale apo dokumentacionit të administruar gjatë veprimtarisë së tij.

Mungesa e përcaktimit të afateve, vërehet si një parregullsi, pasi përcaktimi i kohës së ruajtjes së të dhënave personale është një nga parimet thelbësore të mbrojtjes së të dhënave personale. Përcaktimi i afateve është element thelbësor për të parandaluar rreziqet që mund të vijnë për shkak të mbajtjes së të dhënave përtej afatit. Kjo tregon, gjithashtu, mungesë në zbatimin praktik të procedurave të asgjësimit të të dhënave, të cilat janë po aq të rëndësishme sa vetë ruajtja e tyre, në mënyrë që të parandalohen rreziqet e ruajtjes përtej afatit, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, të parashikuar në pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, i cili kërkon që të dhënat personale të ruhen

vetëm për periudhën kohore që është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe përpunuar.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa konkrete për përcaktimin e afateve konkrete për ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale, duke patur në vëmendje rëndësinë e garantimit të sigurisë së informacionit dhe mbajtjen e dokumentacionit për atë kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 dhe pikës 2, të nenit 48 të Ligjit, si dhe nenit 12 të Udhëzimit nr. 05, datë 16.07.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente” (në vijim “Udhëzimi nr. 5”).

Lidhur me sa më sipër, nga ana e grupit të hetimit administrativ konstatohet se, përmbajta e rregullores nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, si dhe në të nuk parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 dhe 66 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Gjithashtu, konstatohet se, të dhënat sensitive (të dhënat e lidhura me shëndetin/biometrike/penale) të subjekteve të të dhënave që përpunohen nga Kontrolluesi, nuk identifikohen në aktet rregullatore të Kontrolluesit, si dhe për këtë kategori të të dhënave personale nuk janë parashikuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të tyre, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën duhet të parashikohen rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale, konfidencialitetin, aksesin, afatet e mbajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave të përpunuara manualisht dhe elektronikisht, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate për kohën e ruajtjes së tyre, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale, sanksionuar në pikën 5, të nenit 6, pikës 2, të nenit 48 të Ligjit, si dhe nenit 12 të Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave

personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

Në këtë kuadër, Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa shtesë të sigurisë së përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenet 28 dhe 66 të Ligjit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive, e sidomos të dhënave penale, biometrike dhe atyre të lidhura me shëndetin. Mungesa e rregullimit të qartë për këto kategori të dhënash përbën cenim për përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme, Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 28 dhe 66 të Ligjit.

5. Përfaqësuesit e Kontrolluesit kanë deklaruar përmes e-mailit të datës 12.03.2026 se DPB dhe institucionet e varësisë disponojnë dhe përdorin sisteme të ndryshme në funksion të veprimtarisë së tij.
 - Në vijim, Kontrolluesi deklaron se ka në përdorim Sistemin e Kartelave të të Burgosurve, i cili ka për qëllim njohjen e gjendjes së të dënuarit, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me të dënuarin. Ky sistem përpunon të dhëna personale të të dënuarve si dhe të dhëna shëndetësore, policore, psiko-sociale, penale dhe të dhëna mbi edukimin. Sistemi shërben për të menaxhuar të dhënat e personave të paraburgosur dhe të burgosur, nga momenti i pranimit në IEVP e deri në lirim të tij. Krijimi i dosjeve në këtë sistem realizohet nga IEVP-të, të cilat popullojnë modulet me të dhënat personale përkatëse. DPB ka akses në këtë sistem, me të drejta leximi, si dhe për të monitoruar administrimin e sistemit sipas veprimtarisë së sektorëve përkatës.
 - Sistemi i Vërtetimit Elektronik të Gjendjes Gjyqësore, shërben për ruajtjen e informacionit mbi gjendjen gjyqësore të shtetasve dhe lëshimin e vërtetimit të gjendjes gjyqësore. Informacioni në këtë sistem hidhet në mënyrë manuale. Ky sistem ndërvepron edhe më Regjistrin Elektronik të Gjendjes Civile nëpërmjet të cilit shkëmben të dhënat personale të subjekteve të cilët kërkojnë informacion mbi gjendjen gjyqësore. Gjithashtu, Sistemi i Vërtetimit Elektronik të Gjendjes Gjyqësore bashkëvepron me portalin e-Albania nëpërmjet të cilit aplikojnë qytetarët që duan të pajisen me vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Lidhur me sa deklorohet më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, DPB nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ akte rregullatore mbi mënyrën e implementimit, regjistrimit, administrimit të të dhënave, rolet, aksesin e punonjësve dhe funksionimin e sistemit të Kartelave të të Burgosurve dhe Sistemit të

Vërtetimit Elektronik të Gjendjes Gjyqësore, në kundërshtim me nenet 27, 61 dhe pikën 3, të nenit 66 të Ligjit.

DPB nuk ka mundur të dokumentojnë veprimtarinë e përpunimit dhe marrjen e masave të sigurisë, përfshirë politikat e përdorimit të profilizimit, në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit dhe pikën 3, të nenit 10 të Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, DPB duhet të marrë masa të menjëhershme për hartimin, miratimin dhe zbatimin e akteve rregullatore të detajuara që përcaktojnë mënyrën e implementimit, regjistrimit dhe administrimit të të dhënave personale në sistemet e Kartelave të të Burgosurve dhe Sistemit të Vërtetimit Elektronik të Gjendjes Gjyqësore, duke përfshirë qartë rolet, nivelet e aksesit dhe përgjegjësitë e punonjësve, në përputhje me kërkesat e nenit 27, 61 dhe pikës 3, të nenit 66 të Ligjit.

Gjithashtu, DPB duhet të dokumentojë plotësisht të gjitha veprimtarinë e përpunimit të të dhënave personale, duke përfshirë afatet e ruajtjes së të dhënave, politikat e sigurisë, masat teknike dhe organizative të zbatuara, si dhe rregullat mbi përdorimin e profilizimit, në mënyrë që të garantohet transparenca, llogaridhënia dhe përputhshmëria me nenin 61 të Ligjit dhe pikën 3, të nenit 10 të Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit.

- Sistemi i Vizitave dhe Hyrje-Daljeve në IEVP përpunon informacionin lidhur me monitorimin e hyrje-daljeve të vizitorëve/familjarëve, të punonjësve të IEVP, si dhe të burgosurve pranë IEVP-ve.

IEVP Pojskë ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, Urdhrit nr.1583, datë 22.11.2023 “Për menaxhimin e sistemit elektronik të vizitave dhe hyrje-daljeve në IEVP”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPB.

Në zbatim të pikës 2 të Urdhrit të mësipërm, parashikohet se IEVP-të janë përgjegjëse për administrimin dhe plotësimin e të dhënave në dosjet elektronike të sistemit të Vizitave dhe Hyrje-Daljeve.

Gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, si dhe nga përshkrimet e proceseve përpunuese nga Kontrolluesi, deklarohet se ky sistem nuk është funksional, e për rrjedhojë, nuk kryhet asnjë përpunim me të dhëna personale.

Për sa më sipër, konstatohet se, në rregulloren e brendshme dhe aktet e tjera, të cilat ngarkojnë me detyrime ligjore për zbatim, DPB dhe IEVP-të, parashikohen rregulla të paaplikueshme, lidhur me programet dhe sistemet elektronike që përdoren gjatë veprimtarisë.

Parashikimi në akte të brendshme i sistemeve që në praktikë nuk janë funksionale krijon një pasqyrë të pasaktë mbi aktivitetet e përpunimit të të dhënave personale. Kjo bie ndesh me parimin e transparencës dhe detyrimin e Kontrolluesit për të mbajtur dokumentacion të saktë mbi veprimet përpunuese.

Nëse sistemi ekziston teknikisht (edhe pse jo funksional), ai mund të përmbajë të dhëna historike, konfigurime ose akses të pambrojtur. Mungesa e rregullave reale dhe të zbatueshme për këto sisteme mund të krijojë cenueshmëri ndaj aksesit të paautorizuar, rrjedhjeve të të dhënave apo incidenteve të sigurisë.

Për më tepër, Zyra e Komisionerit vlerëson se DPB, IEVP Pojskë, Instituti i të Miturve Kavajë dhe QSB nuk kanë zbatuar detyrimet e parashikuara për funksionimin e sistemit, me qëllim administrimin elektronik të dokumentacionit të të gjitha të dhënave elektronike të vizitave dhe hyrje-daljeve në ambientet e IEVP, si dhe nuk kanë marrë masa për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik, në kundërshtim me parashikimet e germave “b” “c”, “ç”, të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 28 të Ligjit, si dhe germet “g” dhe “f” të pikës 2, të nenit 66 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, DPB dhe IEVP-të duhet të marrin masa për rishikimin dhe përditësimin e menjëhershëm të akteve rregullatore të brendshme, duke siguruar që ato të pasqyrojnë vetëm sisteme reale dhe funksionale të përpunimit të të dhënave personale, si dhe të përcaktojnë qartë mënyrën e administrimit të Sistemit të Vizitave dhe Hyrje-Daljeve në IEVP, në përputhje me kërkesat e nenit 28 dhe 66 të Ligjit. Gjithashtu, lidhur me këtë proces përpunues, duhet të vendosen dhe zbatohen procedura konkrete organizative dhe teknike për funksionimin e sistemit, përfshirë përcaktimin e roleve, niveleve të aksesit dhe përgjegjësi të punonjësve, në mënyrë që të garantohet përpunim i ligjshëm, i sigurt dhe transparent i të dhënave personale.

Po ashtu, DPB dhe IEVP-të duhet të sigurojnë rivendosjen e funksionalitetit të sistemeve elektronike ose, në rast se ato nuk janë në përdorim, të përcaktojnë qartë statusin e tyre dhe të eliminojnë çdo referencë rregullatore të paaplikueshme, me qëllim shmangien e parashikimeve të pasakta mbi aktivitetet përpunuese.

Në të njëjtën kohë, Zyra e Komisionerit vlerëson se duhet të merren masa për garantimin e disponueshmërisë dhe aksesit në të dhënat personale në rast incidentesh teknike ose fizike, duke siguruar mekanizma rikuperimi dhe vazhdimësie të shërbimit, në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 28 dhe 66 të Ligjit.

6. DPB dhe institucionet e saj të varësisë, kanë të instaluar sistemin e video survejimit CCTV, përmes së cilit kryejnë mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtrojnë veprimtarinë, për qëllim të mbrojtjes së pronës, sigurisë në IEVP dhe kontrollit mbi hyrjet dhe daljet.

Nga verifikimet e kryera në terren, rezulton se në sistemin e video survejimit CCTV, kanë akses të kufizuar me të drejtë shikimi, punonjës të IEVP-ve dhe QSB-së, konkretisht: Drejtori i IEVP, shefi i policisë dhe punonjësi i SHKB, të cilët mund të këqyrin pamjet me qëllim monitorimin e lëvizjeve në institucion, për arsye sigurie.

DPB deklaroi gjithashtu, se pamjet filmike ruhen për një afat 15 deri në 45 ditore, në varësi të pajisjeve regjistruese dhe kapaciteteve të HDD.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me nenin 66 të Ligjit dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit” (në vijim “Udhëzimi nr. 3”).

Për më tepër, nga verifikimet e kryera në vend konstatohet se pamjet e përpunuara përmes sistemit të video survejimit CCTV ruhen për një periudhë më të gjatë se afati i deklaruar. Në mungesë të përcaktimit të një afati ligjor, Kontrolluesi dhe Përpunuesit duhet t’i referohen parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Afati i ruajtjes së të dhënave të regjistruara nuk duhet të kalojë periudhën e nevojshme për përmbushjen e qëllimit, për të cilin janë regjistruar këto të dhëna, e lidhur me këtë proces përpunues, DPB dhe IEVP-të kanë vepruar në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të pikës 2, të nenit 3 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Gjithashtu, konstatohet se në ambientet e DPB, nuk janë vendosur tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, me elementët informues sipas modelit standard të miratuar, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave dhe të drejtat që ata gëzojnë, lidhur me përpunimin e të dhënave imazhe/video nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të vendosur në dispozicion, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me nenin 66 të Ligjit dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 3.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi mund të përpunojë të dhënat e subjekteve të të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, për aq kohë sa ekziston qëllimi i ligjshëm, për të cilin ato janë grumbulluar. Në momentin që qëllimi ka përfunduar, DPB, duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave të përpunuara përmes sistemit CCTV, referuar parashikimit të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

Gjithashtu, lidhur me mungesën e tabelave njoftuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë

subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

7. Kontrolluesi disponon faqe zyrtare web <https://dpbsh.gov.al/>. Nga verifikimet e kryera rezulton se, DPB nuk ka hartuar dhe publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit <https://dpbsh.gov.al/>, duke mos përbushur kështu detyrimin ligjor për të garantuar transparencën dhe informimin e subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në të.

Mospërbushja e këtij detyrimi bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit, i cili përcakton se çdo subjekt i të dhënave duhet të informohet në mënyrë të qartë dhe të plotë për qëllimin e mbledhjes dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave të tij personale, kategoritë e të dhënave personale, personat që do t’i përpunojnë apo përfitojnë akses në këto të dhëna, afatet e ruajtjes së tyre, si dhe për të drejtat që ai gëzon sipas legjislacionit përkatës, përfshirë të drejtën për akses, korrigjim, kundërshtim dhe fshirje.

Mungesa e politikave të qarta të privatësisë cenon parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale dhe rrit rrezikun për shkelje të privatësisë dhe të drejtave themelore të individëve. Subjektet që aksesojnë faqen ose ngarkojnë të dhëna personale në të nuk informohen as për masat teknike dhe organizative të sigurisë që aplikohen për mbrojtjen e të dhënave, duke krijuar një boshllëk të rëndësishëm në respektimin e standardeve ligjore dhe etike për mbrojtjen e privatësisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet dhe garantohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave që kryen Kontrolluesi.

8. Kontrolluesi deklaron se sistemet elektronike që DPB disponon, janë të zhvilluara nga palë të treta nëpërmjet kontratave me këto subjekte. Gjithashtu, deklarohet se AKSHI është përgjegjës për administrimin teknik të secilit sistem.

Në këtë kuadër, Kontrolluesi lidhur me sistemet elektronike që disponon, nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ asnjë kontratë shërbimi ose dokumentacion që provon krijimin ose mirëmbajtjen e sistemeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ asnjë kontratë me palë të treta.

Grupi i hetimit administrativ konstaton se, për proceset përpunuese të cilat ofrohen nga palë të treta për DPB, IEVP-të dhe QSB, duhet të përcaktohen të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim “*Udhëzimi nr. 19*”). Këto përcaktime duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë kontrolluesi dhe përpunuesi për të siguruar e garantuar mbrojtjen e të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, duke reflektuar rolet, detyrimet dhe përgjegjësitë mes kontrolluesit dhe përpunuesit, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi, që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar e garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

9. Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në nenet 33, 34 dhe 68 të Ligjit, çdo Kontrollues e Përpunues ka detyrimin të emërojë/caktojë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale që përpunohen gjatë kryerjes së veprimtarisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se, DPB, në cilësinë e Kontrolluesit, si dhe IEVP-të, në cilësinë e Përpunuesve, nuk kanë marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33, 34 dhe nenin 68 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në

mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

10. Gjithashtu, konstatohet se, DPB dhe IEVP-të nuk kanë marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e germave “c” dhe “ç”, të nenit 34 të Ligjit dhe pikës 2, të nenit 5, të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në gërmat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit si dhe pikës 2, të nenit 5, të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të pjesëmarrjes dhe organizimit të trajnimeve të dedikuara për punonjësit që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitohet pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi, nëpërmjet shkresës nr. 433/5 prot., datë 16.04.2026, ka shprehur angazhimin për marrjen e masave lidhur me përmbushjen e disa prej gjetjeve të konstatuara nga grupi i hetimit administrativ. Në lidhje me disa prej konstatimeve të dërguara, Kontrolluesi ka paraqitur pretendimet shkresore, si vijon:

- Lidhur me konstatimin e grupit të hetimit administrativ për afatet e ruajtjes dhe asgjësimit të dokumentacionit sipas kategorive përkatëse që përpunohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Kontrolluesi shprehet se dokumentacioni ruhet në përputhje me listën konkrete të ruajtjes së dokumenteve, të miratuar me shkresën nr. 2440/5 prot., datë 24.05.2024, ndërsa për kategorinë ish-punonjës, dokumentacioni ruhet për efekt të vërtetimit të pensionit për këta të fundit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion provues lidhur me pretendimet e tij, në të cilin vërtetohet se janë përcaktuar afatet konkrete të ruajtjes së dokumentacionit, për

secilën nga kategoritë e subjekteve të të dhënave, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin se ruajtja e dokumentacionit justifikohet për efekt të vërtetimit të të drejtave të pensionit, vlerësohet se ky qëllim nuk përbën bazë të ligjshme për vijimin e përpunimit nga Kontrolluesi, në kuptim të parimit të kufizimit të qëllimit dhe minimizimit të të dhënave, të parashikuara në Ligj. Vërtetimi, administrimi dhe njohja e të drejtave të pensionit rregullohen nga legjislacioni sektorial në fushën e sigurimeve shoqërore dhe ushtrohen nga autoritetet kompetente të ngarkuara shprehimisht me ligj, ndaj ruajtja e këtij dokumentacioni nga Kontrolluesi për kategorinë e ish-punonjësve nuk mund të mbështetet në një qëllim që nuk lidhet me kompetencat apo detyrimet e tij ligjore. Për rrjedhojë, një përpunim i tillë rezulton të jetë tej asaj që është e nevojshme dhe proporcionale për qëllimet për të cilat të dhënat janë mbledhur fillimisht.

Për më tepër, kategori dokumentesh që përmbajnë të dhëna personale, si jetëshkrimi, dokumente identifikimi, diploma, certifikata kualifikimesh, lista notash apo vërtetimi i gjendjes gjyqësore, nuk rezultojnë të jenë të nevojshme për qëllimin e pretenduar të vërtetimit të pensionit dhe nuk paraqesin lidhje të drejtpërdrejtë me këtë proces. Në këto kushte, vijimi i ruajtjes së tyre bie ndesh me parimin e kufizimit të afatit të ruajtjes, sipas të cilit të dhënat personale duhet të mbahen në formë të identifikueshme vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për realizimin e qëllimit të përpunimit. Si të tilla, pas shërimit të qëllimit për të cilin janë mbledhur, këto të dhëna duhet t'i nënshtrohen fshirjes, asgjësimit ose anonimizimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit.

- Kontrolluesi, lidhur me pikën 5 të konstatimeve të procesverbalit, deklaron se sistemi i Gjendjes Gjyqësore, administrohet në përputhje me me ligjin nr. 9154, datë 21.09.20006 “Për certifikatën elektronike të gjendjes gjyqësore”.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se DPB nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ akte rregullatore mbi mënyrën e implementimit, regjistrimit, administrimit të të dhënave, afatet e ruajtjes dhe asgjësimit të të dhënave, rolet, aksesin e punonjësve në këtë sistem, si dhe nuk ka dokumentuar veprimtaritë e përpunimit të realizuara në këtë sistem, në kundërshtim me nenet 27, 61 dhe 66 të Ligjit dhe pikën 3, të nenit 10 të Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit.

- Në pretendimet me shkrim, Kontrolluesi deklaron se me urdhrin nr. 2573, datë 31.12.2025 është caktuar si nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale znj. Sarah Metaj. Megjithatë, as gjatë hetimit administrativ, e as nëpërmjet shkresës nr. 433/5 prot., datë 16.04.2026 të depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, DPB nuk ka vendosur në dispozicion aktin përkatës për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 34 të Ligjit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 27, 28, 33, 34, 48, 61, 66, 68, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, si dhe të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, duke përfshirë edhe ato përmes sistemit të video survejimit CCTV, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të rishikojë rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
3. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave apo politikave, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, lloji dhe specifikimet e kamerave, vendosja e tyre në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren, si dhe përcaktimin e saktë të zonave që do të jenë nën mbikëqyrje etj., sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi të marrë masa për dokumentimin e të gjitha veprimtarive të përpunimit të të dhënave personale, duke përfshirë politikat e sigurisë, masat teknike dhe organizative të zbatuara, si dhe rregullat mbi përdorimin e profilizimit, në mënyrë që të garantohet transparenca, llogaridhënia dhe përputhshmëria, sipas parashikimeve të nenit 61 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi të marrë masa për garantimin e disponueshmërisë dhe aksesit në të dhënat personale në rast incidentesh teknike ose fizike, duke siguruar mekanizma rikuperimi dhe vazhdimësie të shërbimit, në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 28 dhe 66 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, të marrë masa për hartimin dhe publikimin e “*Politikave të Privatësisë*” në faqen e internetit <https://dpbsh.gov.al/>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;

7. Kontrolluesi, të përfshijë në kontratë dhe/ose aneks kontratë, të nënshkuar mes kontrolluesit dhe përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në gjerat “c” dhe “ç” të nenit 34 të Ligjit, lidhur me trajnimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre.
9. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikat 5 dhe 8 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 1, 6 dhe 7 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 2, 3 dhe 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
11. Komisioneri, bazuar në gjerën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 24.04.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi